

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË “DAtelier Beauty” SH.P.K.

NENI 1 – KRIJIMI I SHOQËRISË

Sot, më datë 29/08/2025, themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “DAtelier Beauty” sh.p.k. (në vijim do të referohet si “Shoqëria”), nga ortakët me të dhëna si më poshtë:

- DAJANA QOSHJA, shtetase shqiptare, lindur më 14/12/1996 në Kruje, madhore me zotësi të plotë për të vepruar, banuese në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit me numër personal J66214039M.
- ALTEA NOKA, shtetase shqiptare, lindur më 03/11/1999 në Tiranë, madhore me zotësi të plotë për të vepruar, banuese në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit me numër personal J96103060V.

Shoqëria është person juridik shqiptar dhe funksionon në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të ndryshuar.

NENI 2 – FORMA E SHOQËRISË

1. Shoqëria do të ketë formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.), për sa kohë që Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim për shndërrimin e saj.
2. Veprimtaria e Shoqërisë do të rregullohet sipas ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të ndryshuar, si dhe këtij Statuti.

NENI 3 – EMËRTIMI

Emërtimi i shoqërisë është “DAtelier Beauty” sh.p.k.. Në të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga Shoqëria, emërtimi do të ndiqet nga fjalët “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ose inicialet sh.p.k..

NENI 4 – SELIA E SHOQËRISË

1. Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga “Margarita Tutulani, Ap. Nr. 4, ZK 8270, vol. 56, fq. 29, nr. pasurie 7/319-N4, Tiranë.
2. Shoqëria ka të drejtë të hapë filiale, degë, agjenci dhe zyra përfaqësimi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
3. Selia mund të transferohet në çdo vend tjetër të Republikës së Shqipërisë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 5 – KOHËZGJATJA



Shoqëria themelohet pa afat të përcaktuar. Ajo mund të mbyllet në çdo kohë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme ose në rastet e parashikuara nga ligji.

NENI 6 – OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është:

- Ofrimi i shërbimeve profesionale në fushën e make-up-it dhe kujdesit estetik;

Shoqëria mund të zhvillojë çdo veprimtari tjetër që nuk ndalohet nga ligji dhe që Asambleja e Përgjithshme e konsideron të përshtatshme për arritjen e objektivave të saj.

NENI 7 – KAPITALI THEMELTAR

1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100,000 (njqindmije) lekë.
2. Pjesëmarrja e ortakëve në kapital paraqitet si më poshtë:

Ortaku	Kuota	Vlera (lekë)	Përqindja
DAJANA QOSHJA	1	50,000	50%
ALTEA NOKA	1	50,000	50%
Totali	2	100,000	100%

Kapitali është shlyer plotësisht nga ortakët.

NENI 8 – ORTAKËT

Shoqëria përbëhet nga ortakët si më poshtë:

- DAJANA QOSHJA, zotërues i një kuote prej 50,000 lekë (50% të kapitalit).
- ALTEA NOKA, zotërues i një kuote prej 50,000 lekë (50% të kapitalit).

NENI 9 – ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë dhe vendos për:

- Miratimin e politikave tregtare dhe ndryshimet e Statutit;
- Emërimin dhe shkarkimin e Administratorit, likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
- Miratimin e pasqyrave financiare dhe raporteve të veprimtarisë;
- Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit;
- Pjesëtimin, shitblerjen ose anulimin e kuotave;
- Riorganizimin, shndërrimin ose mbylljen e Shoqërisë;



- Shpërndarjen e fitimeve ndërmjet ortakëve.

NENI 10 – ADMINISTRATORI

1. Shoqëria administrohet nga një administrator i emëruar nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë deri në 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.
2. Administratori përfaqëson Shoqërinë ligjërisht dhe është përgjegjës për menaxhimin e aktivitetit të përditshëm.
3. Për këtë periudhë, Administrator i Shoqërisë caktohet DAJANA QOSHJA.
4. Administratori ka të drejtë dhe detyrime të tilla si: menaxhimi i veprimtarisë, përgatitja e pasqyrave financiare, hapja e llogarive bankare, raportimi përpara Asamblesë së Përgjithshme dhe thirrja e saj kur është e nevojshme.

NENI 11 – DISPOZITA TË FUNDIT

1. Për çdo çështje jo të parashikuar shprehimisht në këtë Akt Themelimi zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.
2. Në rast ndryshimesh ligjore, Statuti përshtatet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
3. Për regjistrimin fillestar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit autorizohet Administratori ose një person i caktuar prej tij.

ORTAKËT THEMELUES:



DAJANA QOSHJA



ALTEA NOKA